



Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

LEGJISLATURA V

Sesioni pranveror

Komisioni për, Administratë Publike, Qeverisje Lokale dhe Media

Mbledhja nr.2

Prishtinë, më 20.01.2015 ora 11:00

Ndërtesa e Kuvendit, salla N – 225

PROCESVERBAL

i mbledhjes së komisionit për Administratë Publike, Qeverisje Lokale dhe Media

Në mbledhje morën pjesë: Zenun Pajaziti, Sadri Ferati, Kujtim Paçaku, Xhevahire Izmaqi, Alma Lama, Shqipe Pantina, Jelena Bontic dhe Zafir Berisha.

Mungoi: Pal Lekaj

Nga stafi mbështetës i komisionit: Drita Morina dhe Mirjeta Heta.

Në mbledhje morën pjesë edhe përfaqësues të OSBE-së, KDI-së, përfaqësuesi i medieve të Kuvendit.

Mbledhjen e kryesoi: Zenun Pajaziti, kryetar i Komisionit.

Për këtë mbledhje është propozuar ky rend dite:

- 1. Miratimi i rendit të ditës;**
- 2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së mbajtur me dt.26.12.2014;**
- 3. Shqyrtimi i draft-planit të punës së Komisionit për vitin 2015;**
- 4. Të ndryshme.**

1. Miratimi i rendit të ditës;

Rendi i ditës u miratua pa ndryshime.

2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së mbajtur me dt.26.12.2014;

Procesverbali i mbledhjes së mbajtur më 26.12.2014 u miratua pa vërejtje.

3. Shqyrtimi i draft-planit të punës së Komisionit për vitin 2015;

Zenun Pajaziti – hapi diskutimin rreth planit të punës dhe i pyeti anëtarët e komisionit se a kanë propozime për ndonjë plotësim apo ndryshim të planit të punës.

Ai propozoi që javën e ardhshme të caktohet një takim me anëtarët e KPM-së për Draft Strategjinë e KPM-së lidhur me kalimin e transmetimit manuel në digjital.

Shqipe Pantina – propozoi që të organizohet një takim tjetër edhe me anëtarët e Bordit të RTK-së, në të cilin takim do të diskutohej rreth çështjeve buxhetore, destinimin dhe planifikimet e vijave buxhetore, si dhe çështjes së vetfinancimit të RTK-së mbi bazë të dispozitave ligjore në

fuqi të Ligjit për buxhetin e vitit 2015, në mënyrë që komisioni të jetë më i njoftuar për muajin prill, kohën kur RTK-ja raporton para Kuvendit me raport vjetor, konform ligjit për RTK-në.

Xhevahire Izmaku - propozoi që takimi i propozuar me anëtarët e KPM-së të jetë takim vetëm me anëtarët e KPM-së pa pjesëmarrjen e institucioneve tjera, kjo për arsye të sqarimit dhe të kuptuarit të qartë të çështjeve që kanë të bëjnë me draft strategjinë për kalimin e transmetimit nga ai manuel në digjital.

Alma Lama – propozoi që takimi me KPM-në të jetë i hapur në kuptimin e pjesëmarrjes edhe të institucioneve apo akterëve të tjerë që kanë të bëjnë me mediat.

Zenun Pajaziti – kërkoi nga anëtarët e komisionit që të mos tejkalohet pika e rendit të ditës dhe që për çështjet që nuk janë pikë e rendit të ditës të diskutohet në pikën e rendit të ditës, të ndryshme.

Sadri Ferati – ai e përkrahu në parim planin e punës së komisionit për vitin 2015, duke mos përjashtuar mundësinë e plotësimit ndryshimit të planit apo edhe inkorporimit të çështjeve të tjera të cilat ndërkohë dalin si çështje me prioritet për shqyrtim nga komisioni.

Sa i përket takimit me anëtarët e KPM-së, të propozuar nga diskutuesit e sipërshënuar, ai mbështet propozimet por në kontekst që takimi mos të kuptohet si takim i komisionit parlamentar, si kontribues në draft strategjinë e KPM-së për digjitalizimin në Kosovë, sepse kjo do të ishte konflikt interesi, por që takimi të jetë vetëm si takim informues për çështjen e digjitalizimit.

Zafir Berisha – përkrahu planin e komisionit me mundësinë e inkorporimit të çështjeve të reja, gjithashtu mbështeti propozimin që takimi me anëtarët e KPM-së të jetë takim njoftues lidhur me çështjen e draft strategjisë së KPM-së për digjitalizimin në Kosovë.

Alma Lama - propozoi që në planin e punës së komisionit për vitin 2015, përkatësisht për muajin shkurt si çështje për diskutim të jetë interpelanca e ministrave të ministrive të cilat bien në fushëveprimtarinë e komisionit, Ministri i Ministrisë së Pushtetit Lokal dhe Ministri i Ministrisë së Administratës Publike.

Kujtim Paçaku – kërkoi që të informohet lidhur me komitetet e komuniteteve nëpër komuna, përkatësisht komitetin e komunitetit romë, si dhe të informohet nga RTK-ja, se sa e ka shfrytëzuar buxhetin RTK-ja për emisionin në gjuhën rome dhe a mjafton buxheti aktual i RTK-së për përmbushjen e emisioneve televizive në gjuhën rome.

Zenun Pajaziti - tha se të gjitha çështjet do të trajtohen, për më tepër çështjet që janë të përcaktuara me ligj, ndërsa për çështjet e shtruara në komision do të shqyrtohen sipas prioritetit dhe afateve ligjore dhe e njëjta vlen edhe për RTK-në.

Konstatim:

Komisioni miratoi, në parim, planin e punës me plotësimet e propozuara.

4. Të ndryshme.

Anëtarët e komisionit diskutuan për organizimin e dy takimeve: me anëtarët e KPM-së dhe Bordin e RTK-së.

Komisioni miratoi propozimin për organizimin e takimeve të sipërshënuara.

Mbledhja përfundoi në ora: 12:10.

Përgatitur nga :

Njësia për Mbështetjen e Komisionit

**Kryetari i Komisionit
Zenun Pajaziti**
